



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni i Pavarur i Mediave/ Nezavisna Komisija Za Medije/
Independent Media Commission

Datë: 22.07.2024

Kryesuesi i Komisionit ad hoc të Pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media, Bislim Bislimi, në përputhje me nenin 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, merr këtë:

V E N D I M

1. Shtyhet afati për përfundimin e procedurës së vlerësimit të kandidatëve përmes intervistës për pozitën: Kryeshef Ekzekutiv në Komisionin e Pavarur për Media, me numër të referencës RN00013944.
2. Afati për përfundimin e procedurës administrative sikurse në pikën një (1) të këtij Vendimi shtyhet për 15 ditë pas datës së skadimit të afatit fillestar për përfundimin e procedurës së vlerësimit të kandidatëve përmes intervistës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Për shkak të domosdoshmërisë për të kryer shqyrtime shtesë administrative, në të mirë vlerësimit të themeltë, të plotë dhe gjithëpërfshirës të të gjitha elementeve të rëndësishme që e përbëjnë thelbin e çështjes administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, nuk është lejuar ankesa.

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Bordit të KPM ;
- Anëtarëve të Komisionit Ad Hoc;
- Palëve në procedurë të konkurrimit;
- Arkivit të KPM.

Bislim Bislimi